



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 105, Datë 21.04.2026

MBI

ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “HYDROSOLAR ENERGY (HSE)” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.04.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 828/8 prot., datë 17.04.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “HYDROSOLAR ENERGY (HSE)” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “HYDROSOLAR ENERGY (HSE)” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 828 prot., datë 05.03.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet 2 MW, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 82, datë 19.03.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.03.2026 dhe 21.03.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 30.03.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.
- ERE nëpërmjet shkresës nr. 828/3 prot., datë 25.03.2026 ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure dhe gjithashtu i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 828/7 prot., datë 14.04.2026, MIE është shprehur parimisht dakord për fillimin e procedurave për pajisjen e shoqërisë me licencën e prodhimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën nr. 828/4 prot., datë 25.03.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës, si dhe për informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim konkretisht: *dëshminë e penalitetit për vetë shoqërinë “HYDROSOLAR ENERGY*

(HSE) sh.p.k.; sqarime në lidhje me strukturën organizative aktualisht efektive; letër interesi nga banka të përditësuar dhe deklaratën e ortakut të shoqërisë mbi financimin e 20% të vlerës së projektit; saktësimin e datës së parashikuar për fillimin e operimit dhe sqarime në lidhje me jetëgjatësinë e centralit; si dhe informacion nëse kanë filluar punimet e centralit dhe sqarime/korrigjime në lidhje me vendndodhjen e projektit, në referencë të kontratës me MIE-n. Detyrimi për depozitimin e këtij dokumentacioni i është rikujtuar shoqërisë edhe nëpërmjet e-mailit të ERE-s nr. 828/5 prot., datë 10.04.2026.

- Me e-mailin e datës 12.04.2026, shoqëria ka bërë me dije se shkresa e sipërcituar e ERE-s, nuk është dorëzuar në zyrën e saj dhe se ka marrë dijeni për kërkesat e ERE-s vetëm nëpërmjet e-mailit të datës 09.04.2026, duke informuar gjithashtu se dokumentacionin e kërkuar, do ta dorëzojë fizikisht në ERE, sapo ta ketë gati.

Zgjatja e vendimmarrjes

- Në nenin 14, pika 3 të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, parashikohet se: *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.*
- Me qëllim për t’i dhënë mundësinë shoqërisë për të plotësuar dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi vlerësohet që të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “HYDROSOLAR ENERGY (HSE)” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacionin/dokumentacionin përkatës brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “HYDROSOLAR ENERGY (HSE)” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier.
2. Brenda 20 (njëzet) ditëve, shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “HYDROSOLAR ENERGY (HSE)” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI